

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kanadaja
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kanadaja-anetare-e-asociuar-e-bese-cfare-do-te-thote-dhe-si-mund-te-funksionoje
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:03:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:57:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b587dfce1b8db62fc7ba4951975f39176a26dc1eb5deba89c2bc72f7ce87073db
TEKSTI	d516da7eb178fadc87c24be90fa9e3f7ac85b3cf18b06a0e6e2bb954939e4b63
PAMJA	f21f1d980a8b92c6c90aaaf875b1eb2d6d264566ea84c2ba266438d4627d8a24

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	39c57a32f4918c9471d2425cd0cde99ebfc2051e37acb395897ec45365e68d00
E MËPARSHMJA	ca94dedb9354f5244a469fd410d450b52f3119381c8ea74971eec5b2cbd32b31
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/39c57a32f4918c9471d2425cd0cde99ebfc2051e37acb395897ec45365e68d00>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Ylli Pata: Flamingot çfarë janë sot, lëvizje apo revolucion?



Bota

Kanadaja 'anëtare e asociuar' e BE-së? Çfarë do të thotë dhe si mund të funksionojë

Në praktikë, një "anëtarësim i asociuar" i Kanadasë nuk do të nënkuptonte anëtarësim në BE, por një formë të re dhe më të ngushtë partneriteti, që mund të përfshijë mbrojtjen, sigurinë ekonomike, teknologjinë, energjinë, infrastrukturën dhe tregtinë.



Ursula von der Leyen, Mark Carney dhe Antonio Costa



Redaksia

17 Shtator, 17:55 | Përditësimi: 17 Shtator, 17:58

f Share Tweet



A A

Presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, ka bërë thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë me Kanadanë, duke theksuar se Bashkimi Europian dhe Kanadaja "e shohin botën me të njëjtët sy".

Në fjalimin e saj për Gjendjen e Unionit në Parlamentin Europian, von der Leyen përmendi teknologjinë, prodhimin e armëve, inteligjencën artificiale dhe politikën për Arktikun si disa nga fushat ku mund të thellohet bashkëpunimi. I ftuari i saj i nderit në Strasburg ishte kryeministri kanadez Mark Carney, i cili përpara mbërritjes në Europë deklaroi se synon një "aleancë unike" me BE-në.

Deklarata e tij erdhi pas raportimeve se Kanadaja po shqyrton mundësinë e një statusi si "anëtare e asociuar" e Bashkimit Europian, por pa synuar anëtarësimin e plotë.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Derisa të jemi kaq të këqinj dhe kundër njëri-tjetrit përballë të huajve...

Çfarë forme mund të marrë bashkëpunimi?

Anëtarësimi i plotë i Kanadasë në Bashkimin Europian nuk është një mundësi sipas traktateve aktuale, pasi neni 49 i Traktatit të BE-së parashikon se vetëm shtetet europiane mund të aplikojnë për anëtarësim.

Megjithatë, BE-ja ka forma të ndryshme bashkëpunimi me vendet që nuk janë anëtare, nga marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe marrëveshjet e asociimit deri te pjesëmarrja në tregun e

përbashkët, si në rastin e Islandës, Lihtenshtajnit dhe Norvegjisë. BE-ja ka gjithashtu marrëveshje asociimi me vende si Turqia, Izraeli dhe Ukraina, të cilat mund të jenë, por jo domosdoshmërisht janë, një hap drejt anëtarësimit.

Eksperti i ekonomisë Patrick Leblond, nga Universiteti i Otavës, shprehet skeptik për përdorimin e termit “anëtarësim i asociuar”. Sipas tij, ka pak gjasa që Kanadaja të pranojë legjislacionin europian apo të hyjë në tregun e përbashkët ose në bashkimin doganor të BE-së.

Ai vlerëson se synimi i Carney-t është më tepër krijimi i një aleance të përqendruar të sigurisë ekonomike dhe mbrojtja.

Bashkëpunim më i madh në mbrojtje

“Deri tani, në një farë mënyre, të dyja palët e kemi marrë si të mirëqenë ombrellën amerikane të sigurisë”, tha Leblond, duke shtuar se si BE-ja, ashtu edhe Kanadaja, për këtë arsye nuk kanë investuar mjaftueshëm në ushtritë e tyre.

Tashmë synimi është bashkimi i forcave në fusha si prodhimi i armatimeve dhe zhvillimi i teknologjive të reja.

Edhe eksperti i sigurisë Anand Sundar, nga European Council on Foreign Relations, sheh potencial të madh për bashkëpunimin europiano-kanadez në mbrojtje.

Aktualisht, Kanadaja shpenzon rreth 70% të buxhetit të saj të mbrojtjes në SHBA, por Carney kërkon ta ndryshojë këtë. Pjesëmarrja në projektet europiane të mbrojtjes mund të jetë ekonomishtë më e favorshme për Kanadanë.

Kanadaja i është bashkuar tashmë programit SAFE, i cili u siguron vendeve të BE-së deri në 150 miliardë euro kredi për blerjen e përbashkët të armatimeve. Për shkak se Kanadaja ka paguar një tarifë për t’iu bashkuar programit, kompanitë e saj përfitojnë nga rregulla më fleksibël për origjinën e komponentëve.

Megjithatë, Sundar thekson se vazhdojnë të ekzistojnë pengesa të rëndësishme për kompanitë kanadeze që duan të bashkëpunojnë me ato europiane. Një nga çështjet kryesore është se deri në çfarë mase BE-ja është e gatshme të përshtatë rregullat e saj, pasi ndryshimet mund të kenë pasoja edhe për partnerët të tjerë, si Mbretëria e Bashkuar apo Norvegjia.

Nga ana tjetër, edhe BE-ja mund të përfitojë nga një bashkëpunim më i ngushtë me Otavën. Kanadaja shpenzon për mbrojtjen më shumë se 14 vendet më të vogla të BE-së të marra së bashku. Aktualisht ajo shpenzon rreth 2% të PBB-së për mbrojtjen, ndërsa si anëtare e NATO-s është angazhuar që deri në vitin 2035 shpenzimet të arrijnë në 5% të PBB-së.

Infrastrukturë, energji dhe tregti

Një tjetër fushë bashkëpunimi mund të jetë infrastruktura kritike, përfshirë menaxhimin e përbashkët të satelitëve dhe kabllove me fibra optike në Atlantikun e Veriut.

Sipas Leblond, edhe këtu synimi do të ishte zvogëlimi i varësisë nga SHBA-ja dhe kompanitë amerikane. Kanadaja ka gjithashtu rezerva naftë dhe gazi që mund të përdoren për furnizimin e vendeve të BE-së.

Marrëdhëniet tregtare mes dy palëve rregullohen tashmë nga Marrëveshja Gjithëpërfshirëse Ekonomike dhe Tregtare, CETA, e cila zbatohet përkohësisht që prej vitit 2017.

Marrëveshja ka hequr pothuajse të gjitha tarifatat doganore, rregullon hyrjen e produkteve industriale dhe bujqësore në treg dhe u mundëson kompanive europiane të marrin pjesë në tenderët publikë në [Kanada](#).

Leblond vlerëson se potenciali i CETA-s ende nuk është shfrytëzuar plotësisht, pasi shumë kompani kanadeze vazhdojnë të orientohen tradicionalisht drejt tregut amerikan.

Pse Kanadaja po afrohet me Europën?

Në fillim të vitit, në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, Mark Carney deklaroi se rendi i vjetër botëror po shpërbëhet dhe u bëri thirrje fuqive të mesme të bashkëpunojnë, në mënyrë që të mos përfundojnë “në menynë” e fuqive të mëdha.

Gjatë javëve të fundit, përplasjet tregtare mes SHBA-së dhe Kanadasë janë ashpërsuar më tej, të shoqëruara edhe me sulme verbale nga presidenti amerikan.

Megjithëse Kanadaja nuk mund të shkëputet ekonomishtë dhe strategjishtë nga SHBA-ja, sipas Leblond në vend po forcohet bindja se Otavës i duhen aleatë të tjerë dhe Europa shihet si një partner i besueshëm.

Në praktikë, një “anëtarësim i asociuar” i Kanadasë nuk do të nënkuptonte anëtarësim në BE, por një formë të re dhe më të ngushtë partneriteti, që mund të përfshijë mbrojtjen, sigurinë ekonomike, teknologjinë, energjinë, infrastrukturën dhe tregtinë.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [BE](#) [kanada](#)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente



Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera

**Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri mbledhet në 21 dhe 22 shtator**

19 Shtator, 19:04

**Verdikti i Hagës për krerët e UÇK-së, BE mesazh rajonit: Respektoni vendimet, ndihmoni në shërimin e plagëve të së kaluarës**

18 Shtator, 18:23

**Kanadaja mirëpret afrimin me BE-në, Kryeministri Carney në Parlamentin Europian: Së bashku jemi më të fortë! Trump: Nëse e shoh të rrezikshme do vendos tarifa**

17 Shtator, 13:17

**BE propozon një arkitekturë të re sigurie për Evropën: Këshill të ri, protokoll emergjence dhe investime në mbrojtje**

17 Shtator, 09:17

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Walker: Ditë e kobshme për Kosovën! Ku ishte BE-ja kur serbët dhunonin shqiptarët?**

17 Shtator, 08:22

**Haga dënoi me 81 vite burg Thačin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, veterani i UÇK për Report Tv: S'kemi për t'ja falur Europës, duhet të burgoseshin kriminelët serbë, jo ne!**

16 Shtator, 17:56

**BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët në Gjermani, numri arrin rekordin e 124 mijë**

14 Shtator, 07:00

**Pas dështimit të bisedimeve tregtare me SHBA-në, Kanadaja kërkon statusin e 'anëtarit të asociuar' në Bashkimin Europian**

13 Shtator, 17:57

**Sfida më e madhe e tranzicionit? Rama: Ëndrra e Bashkimit Europian bën diferencën (VIDEO)**

13 Shtator, 14:24

**IPARD III ende i bllokuar, Komisioni Evropian për Report TV: Nuk kemi afate për hapjen e tyre! Fondet e keqpërdorura****Rusia godet pranë kufirit me Poloninë, Kiev paralajmëron BE-në: Barbarët rusë janë në dyert tuaja! Trump-****Investimi në Sazan/ Rama: Kur unë kam nisur diskutimet, s'dihej nëse Trump do ishte President apo në burg! Kur dera e**

dunet te ktnehen



Eliza Gjedi

13 Shtator, 12:49

Zelenskyt: Ndal suimet
ndaj rafinerive ruse

13 Shtator, 11:37

BE te napet, do shpetoni
nga une

11 Shtator, 20:29

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.